

42 vjeçari që u vra në Skenderaj dhe i dyshuari janë familjarë- Detaje për ngjarjen e rëndë



12/02/2025 15:06

f

t

l

Qytetarët e Skenderajt sot janë tronditur nga një ngjarje e rëndë.

Në shesh të qytetit, saktësisht në një prej kafiterive që ndodhen aty është vrarë një burrë, 42 vjeçar.

Rasti në fjalë është konfirmuar edhe nga Policia e Kosovës.

Sipas të dhënave të para thuhet se rasti ka ndodhur sot pasdite, në një prej kafiterive.

Viktimë në këtë rast raportohet të jetë burri me inicialet I.I nga fshati Klinë e Ulët, në Skenderaj.

Edhe më e rëndë situata në këtë rast është për shkak se viktima dhe i dyshuari në këtë rast janë familjarë.

“Sot rreth orës 13:50 policia në Skenderaj ka pranuar informatën për të shtëna me armë zjarr në rrugën Sala e Hamit Jashari. Sipas informative fillestare të shtënat kanë ndodhur brenda një lokali ku si pasojë e të shtënave nga arma e zjarrit dhe plagëve të pësuar ka humbur jetën viktimë mashkull i moshës 42 vjeçar, shtetas i Republikës së Kosovës. Rrjedha hetimore po zhvillohet në drejtim të identifikimit dhe arrestimit të një personi të dyshuar”, thuhet në njoftim./Lajmi.net/

Më shumë nga uebi

nativeGRAM
by LuponMedia



Other Links

- Fact-Checking Policy
- Ethics Policy
- Corrections Policy
- Ownership & Funding Information
- Editorial Team Information

RRJETET SOCIALE

